



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT**

VENDIM

Nr. 13/1, datë 15.05.2019

MBI

**“MIRATIMIN PËR PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT TË
STUDENTIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR, PËR VITIN AKADEMIK 2018-
2019, NË FAKULTETIN E ARTEVE TË BUKURA, TË UNIVERSITETIT TË
ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 269, date 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit” (i ndryshuar); urdhrin e Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 51, datë 03.12.2018 mbi “Ngritjen e grupit të punës për pranimin e aplikimeve të studentëve, të cilët përjashtohen/reduktohen nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2018-2019, në Universitetin e Arteve” (i ndryshuar), si dhe bazuar në kërkesën e studentit të Fakultetit të Arteve të Bukura Alban Xhafa me datë 22.04.2019, Bordi i Administrimit pasi diskutoi rreth Relacionit në lidhje me kërkesat e studentëve, paraqitur nga Administrator i UART znj. Alma Sinanaj dhe duke u bazuar në aktet e dala për këtë qëllim dhe pasi e diskutoi,

V E N D O S I:

1. Miratimin për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, të studentit Alban Xhafa, ciklit i parë i studimeve Bachelor, në programin e studimit Pikturë Kavaleti, të Fakultetit të Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve, për vitin akademik 2018-2019.
2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë dhe Agjencisë Kombëtare së Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

